



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2039/1 prot.,

Datë 31.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar-Shërbim*”, me Nr. REF-34879-12-30-2024, me objekt “*Loti 1: Mirëmbajtje me performancë: Librazhd – Fushë Studë – Borovë – Sebisht (35.5) + Urakë - Golik, (8.6). L= 44.1 km (Rishpallje)*”, me fond limit 134,481,255.66, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik, “REJ” SHPK me NIPT J93711608Q dhe me adresë: Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar me adresë “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Në datën 30.07.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5616, me nr. protokolli 2039/2025 datë 30.07.2025 i operatorit ekonomik, “REJ” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar-Shërbim*”, me Nr. REF-34879-12-30-2024, me objekt “*Loti 1: Mirëmbajtje me performancë: Librazhd – Fushë Studë – Borovë – Sebisht (35.5) + Urakë - Golik, (8.6). L= 44.1 km (Rishpallje)*”, me fond limit 134,481,255.66, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë objektin e pretendimeve që operatori ekonomik ankimues “REJ”

SHPK, parashtron në ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5616, me nr. protokolli 2039/2025 datë 30.07.2025.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij, ndër të tjera citon si më poshtë vijon:

“[...]Autoriteti kontraktor është mjaftuar me një argumentim sipërfaqësor të arsyeve që kanë cuar në anulimin e procedurës së prokurimit, ose më saktë thjesht ka përzgjedhur një nga alternativat që përdoret për anulimin e procedurës sikurse ka parashkuar gërma “ç” e pikës 1 të nenit 98 të LPP-së por nuk ka dhënë asnjë argument se cilat kanë qënë këto rrethana të paparashikueshme deh objective që e kanë detyruar autoritetin kontraktor të anulojë procedurën ?! apo cilat kanë qënë ato rrethana që kanë ndryshuar aftësinë paguese të autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi ?! Pse Eshte vonuar vlerësimi i ofertave per gati 3 muaj? Afati per dorzimin e ofertave ekonomike ne Fazen 2 ka qene Data 29.04.2025 dhe pas 3 muajve AK vendos te anulloje kete procedure pa kryer vleresimin e ofertave ekonomike duke cenuar keshtu sigurine juridike te OE pjesmarres.

...Në analizë të të gjithë argumentave të mësipërme, del shumë e qartë që mungon shkaku i ligjshëm për anulimin e kësaj procedurë prokurimi. Sikurse e theksuam dhe më lart kjo është një procedurë marrveshje kuadër e cila do të zgjasë 4 vite gjithacka është e parashikuar dhe nuk ndryshon asnjë rrethane, pasi edhe sikur të jete kështu është po vete autoriteti kontraktor që pavarësisht se nënshkruan marrveshjen kuader nuk ka detyrim te lidhi kontrate nese nuk ka kerkese per ofrimin e sherbimeve per te cilat zhvillohet ky prokurim. Pra rezulton se argumentat e autoritetit kontraktor për anulimin e kësaj procedure janë krejtësisht të paargumentuara dhe arsyetuara ligjerisht, çka përben mungesen e shkaktut te ligjshëm për anulimin e saj dhe se ky vendim duhet te revokohet.

Të gjitha argumentat e mësipërm, të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se veprimet për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk janë objektive dhe aspak të bazuara në ligje dhe akte nënligjore.

Sa më sipër perfundimisht kërkojmë:

a-) Pranimin e ankesës

b-) Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit.

c-) Rikthimin në SPE të procedurës objekt ankese dhe urdhërimin e KVO për të vijuar me vlerësimin e ofertave dhe publikimin e njoftimit të klasifikimit përfundimtar të tyre.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro